



Adresa: Rr."Sami Frashëri", Tiranë

E-mail: petroninitirane@yahoo.com

Telefoni: 0698625502



PNL- Një shkollë miqësore për të gjithë

Veprimtari të shkollës qendër komunitare
gjatë vitit shkollor
2016-2017

Një vit elitar , histori suk-
sesi , individë të së ardhmes !
Në 58 vite histori , me i suk-
sesshmi në pjesëmarrje , risi
e inovacion .

Petro Nini Luarasi ka përm-
byllur një vit plot arritje :
akademike, me olimpiada
kombëtare e
ndërkombëtare të fituara ; so-
ciale , si shembull i pashoq i
vlerave qytetare e atyre hu-
mane ; artistike ,
pasqyrim i shpirtit artistik që
thyen dhe barrierat e kufijve
kombëtar .

Një trinom mes lirisë së të
menduarit që shpaloset në
shumëllojshmërinë e veprim-
tarive
gjithëpërfshirëse , përgjeg-
jësisë shoqërore pasqyruar në
fushatën kombëtare mbi
edukimin ligjor e
qytetar dhe unikalitetit ar-
tistik ku talenti përbënte
kryefjalën e çdo veprimtarie .
Krenari e shtuar për Petron-
insat , mbi të gjitha shpresë
për të ardhmen që do të ndër-
tojë ky brez!

TREGUESIT 2016-2017		Vle- ra e tre gue sit
1	Përqindja e nxënësve të larguar nga shkolla	0.0 7%
2	Përqindja e orëve të munguara nga nxënësit, kundrejt të gjitha orëve mësimore të një viti shkollor	0.0 03 %
3	Përqindja e nxënësve kalues në Provimet e Maturës Shtetërore	99. 3%
4	Nota mesatare e shkollës në Provimet e Maturës Shtetërore.	8.5
6	Diferenca ndërmjet vlerësimit të Maturës Shtetërore dhe vlerësimit të këtyre lëndëve në përfundim të klasës së dymbëdhjetë.	
1	Numri mesatar i krediteve të fituara nga punonjësit arsimorë të shkollës (drejtor, nëndrejtor, mësues) gjatë viti shkollor.	3.3 4
1	Realizimi i objektivave të planit vjetor për vitin shkollor 2016-2017.	2
1	Numri i fituesve të shkollës në konkurrimin kombëtar që shpall MAS-i .	15. 75
1	Numri i cmimeve fituese të shkollës në konkurimet që shpall DAR.	18
1	Përqindja e pjesëmarrjes së punonjësve arsimorë (drejtues dhe mësues) në rrjetet profesionale.	100 %
1	Rezultatet e mësuesve në provimet e kualifikimit gja	331
1	Përqindja e nxënësve fitues në tri preferencat e para në konkurimin për shkollat e larta	
1	Numri i projekteve që shkolla ka fituar në nivel kombëtar ose ndërkombëtar për vitin shkollor 2016-2017.	65
SHUMA		
VENDI I SHKOLLËS NË RENDITJEN TËRËSORE		

Fitues i olimpiades

Olimpiada e 58-të ndërkombëtare e matematikës në Rio De Janeiro, Brazil. Fitues i medaljes së bronzit.

Lorenc Bushi



SIGURIMI I MIRËQENIES SOCIALE, EMOCIONALE DHE SHËNDETËSORE TË NXËNËSVE

Maj 2017

Qëllimi: Të promovojë interesat , aftësitë , e nxënësve në klube të ndryshme social kulturore dhe përfshirjen e tyre pa dallime.

Vallet Popullore nga trevat shqiptare



Në kuadër te veprimtarive artistiko-sportive të përcaktuara në planin e departamentit të Edukimit Fizik për muajin Maj departamenti jonë në bashkëpunim me departamentin e historisë organizuan një pasdite argëtuese me valle popullore nga trevat e ndryshme të Shqipeërisë ,ushqime tradicionale dhe objekte të ndryshme të trashëgimisë kulturore. Nxënës të shkollës së bashku me prindërit dhe me mësuesit e shkollës kaluan një mbasdite argëtuese.



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR SHKOLLËN

DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE QYTETIT TIRANË

Gjimnazi "PETRO NINI LUARASI "

Numri I nxënësve të rregjistruar në fillim të vitit të kaluar shkollor : Gjithsej **1304** nxënës

Objektivat e planit vjetor:

a. Të rrisim notën mesatare të shkollës me **1%**

b. Të ulim numrin e mungesave vjetore ne **10%**.

Përqindja e kalueshmërisë në fund të vitit të kaluar **98%**

Nota mesatare e shkollës në fund të vitit të kaluar shkollor **8.4**

70% e prindërve me arsim të lartë;

Shkolla realizon procesin mësimor vetem me një turn.

Vendodhja e shkollës favorizon prurje cilësore.

*Shkolla ofron katër gjuhë të huaja: **anglisht, italisht, frëngjisht, gjermanisht.***

Shkolla ofron module në interes të nxënësit, p.sh. Sipërmarrja, Arte, PEGJ etj.

*Mësuesit e shkollës janë pjesë e ekipit hartues dhe vlerësues të **MATURËS***

SHTETËRORE.

15% e mësuesve të shkollës janë autorë të teksteve shkollore.

16 mësues janë me titullin "Mësues mjeshtër "

Arritje të këtij viti shkollor

*Në **arritjet lëndore** fitues në olimpiadën Ballkanike në Maqedoni ne matematikë,*

në olimpiadën ndërkombëtare në Rio De Zhaneiro në matematike vendin e trete.

*Në **arte** multimedia nxënësit e shkollës sonë në festivalin ndërkombëtar në Itali*

GEF vendin e dytë.

*Në **sport** fitues në kampionate të futbollit vajza, basketbollit djem dhe volejboll vajza.*

Në Tirana Art Fest fitues në multimedia, këngë dhe kërcim.

Adresa elektronike: www.facebook.com/55vjetPNL

E-mail: petroninitirane@yahoo.com

Takimi me bordin dhe komitetin e prinderve.

Tetor 2016

Qëllimi: Grupet e interesit të vlerësojnë burimet e vlefshme në komunitet që lidhen me përmbushjen e nevojave të nxënësve në shkollë.

Në fillim të vitit shkollor, shkolla ftoi në bashkëpunim, në një takim të gjere, të gjitha grupet e interesit që lidhen drejtpërdrejt me shkollën, për të vlerësuar nevojat dhe për të hartuar planet afatshkurtra dhe afatmesme. Në këto takime rezultative u morën iniciativa të rëndësishme për nevojat metodiko-pedagogjike dhe infrastrukturore të shkollës.



SIGURIMI I MIRËQENIES SOCIALE, EMOCIONALE DHE SHËNDETËSORE TË NXËNËSVE

Maj 2017

Qëllimi: Të promovojë interesat , aftësitë , e nxënësve në klube të ndryshme social kulturore dhe përfshirjen e tyre pa dallime.



Miqtë që falin vetëm dashuri

Në kuadër të veprimtarive praktike të përcaktuara në planin e punës si shkollë qendër komunitare në departamentin e shkencave sociale shkuan te streha e kafshëve.

Një masë e madhe nxënësish morën pjesë së bashku me mësuesen Mirela Katundi.

SIGURIMI I MIRËQENIES SOCIALE, EMOCIONALE DHE SHËNDËTËSORE TË NXËNËSVE

Maj 2017

Qëllimi: Të promovojë interesat , aftësitë , e nxënësve në klube të ndryshme social kulturore dhe përfshirjen e tyre pa dallime.

Festivali ndërkombëtar i GEF

Jemi mësuar shpesh që të marrim pjesë në konkurse kombëtare po këtë herë shkolla jonë konkuroi në festivalin ndërkombëtar të GEF Itali për prezantimin e filmit me metrazh të shkurtër. Ky projekt u prezantua nga klasa XI-H në bashkëpunim me mësuesen e Italishtes Albana Muceku si dhe me mbështetjen e nëndrejtoreshës Manjola Daulle. Shkolla jonë fitoi vëndin e dytë në këtë konkurs prestigjioz. Suksese!



Mbledhje e grupit koordinator te Shkolles Qender Komunitare

Tetor 2016

Qëllimi: Grupi koordinator mbledhet te percaktoje detyrat, planifikojë veprimtarite dhe te analizoje pritshmerite ne aktivitetet e Shkolles Qender Komunitare

Ne fillim te vitit akademik, grupi koordinator mbledhet per te reflektuar mbi arritjet e nismave te marra ne vitin e meparshem shkollor. Analizon veshtiresite dhe mosarritjet e planifikuara ne vitin e kaluar. Perpunon synimet dhe objektivat per kete vit. Planifikon projekte dhe veprimtari per aktivitetin e Shkolles Qender Komunitare per vitin akademik 2016-2017. Anetaret e grupit koordinator brenda stafit u mbeshteten edhe nga pjese-marres te tjere te grupeve te interesit.



Takim me prindërit e nxënësve të klasave të 10-ta

Tetor 2016

Qëllimi: Njohja dhe motivimi i prindërve me ndryshimet që ka pësuar kurrikula e gjimnazit vitet e fundit.

Në këtë takim me prindër diskutohet rreth kurrikulës së gjimnazit. Prindërit njihen me lëndët që ofron shkolla, mundësitë e zgjedhjeve për nxënësit/fëmijët dhe kreditet për lëndë të caktuara.



Veprimtari për zhvillimin artistik, kulturor e sportiv.

Maj 2017

Qëllimi: Të nxisë, afrojë, tërheqë dhe zhvillojë partneritet me komunitetin e gjerë brenda dhe rreth shkollës

“Open day 2017”

Në kuadër të veprimtarive praktike të përcaktuara në planin e punës si shkollë qendër komunitare në datën 16 maj nxënësit tanë shkuan në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë. Ky aktivitet u mbështet nga DART. Morën pjesë nxënës të klasave të XI-ta.



SIGURIMI I MIRËQENIES SOCIALE, EMOCIONALE DHE SHËNDETËSORE TË NXËNËSVE

Maj 2017

Qëllimi: Të promovojë interesat , aftësitë , e nxënësve në klube të ndryshme social kulturore dhe përfshirjen e tyre pa dallime.

Në datën 18 maj maturantët e shkollës tonë morën pjesë në panairin Work&StudyKy projekt u mbështet nga MAS dhe bashkia Tiranë.Në panair morën pjesë maturantët e shkollës tonë.



Aktivitet mbi prezantimin e faqes së web të klubit të matematikës

Tetor 2016

Qëllimi: Njohja nga nxënësit e shkollës dhe komuniteti(nxënësit e klasave të 9-ta) për funksionet ndihmuese të klubit.

Anëtarësimi në klubin e matematikës.

Realizimi i formatit të regjistrimit,shpërndarja e tyre. Ndërtimi i posterave informues.



Gjimnazi Petro Nini Luarasi



Klubi i Matematikës

"Bashkë udhëtarë të nxënësve dhe komunitetit në udhëtimin e bukur të matematikës."

Pranë çdokujt. Kudo. Kurdo.

9-vjeçare

- Ndihmojmë nxënësit për përforcimin e njohurive të matematikës si dhe për përgatitjen e Provimeve të Lirimit.

Gjimnazistët

- Klasat e 10, 11, dhe 12 kanë mundësi të mësojnë nëpërmjet argëtimit dhe metodave bashkëkohore pranë miqve dhe mësuesve.

Komuniteti

- Si një nga shkollat "qendër komunitare", ofrojmë ndihmë për secilin që e ndjen të nevojshme, pavarësisht moshës, arsimit apo profilit.

Për më shumë informacion vizitoni : <http://matematikapnl.weebly.com>

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT DREKTORIA ARSIMORE
RAJONALE E QYTYTIT TIRANË
GJIMNAZI "PETRO NINI LUARASI" TIRANË
Adresa: Rr. "Sami Frashëri" e nr.1@petroniniluarasi.edu.al/
sami.frasheri@petroniniluarasi.edu.al

Klubi Social ne shtepine e te Moshuarve

Tetor 2016

Qëllimi: Nxitja e bashkepunimit ne grup dhe harmonise mes femijeve, komunitetit dhe te moshuarve

Një ditë në shtëpinë e të Moshuarve Klubi social i shkollës i shoqeruar me mësuesit e Shkencave Sociale vizituan shtëpinë e të Moshuarve. Ky ishte nje aktivitet i vecantë ku nxënësit e shkollës sonë treguan vlerat e tyre, dashuri, solidaritet dhe humanizëm. Pas disa bisedave dhe një dreke të thjeshtë me të moshuarit, ata organizuan lojra nga më të ndryshmet.



Veprimtari për zhvillimin akademik të nxënësve 2016

Maj 2017

Qëllimi: Të plotësoje nevojat e nxënësve me njohuri të thelluara në fushën e Matematikës dhe kimisë

1. Konsultime

2. Përditësimi i faqes së ëeb-it (Rea Tresa)

- Video për limitet
- Projekt "Ndërtimi i grafikëve të funksioneve të përbërë trigonometrikë.
Përdorimi i TIK në funksion të interpretimit matematik.
- Detyra matematike për klasën e IX-të dhe maturantët (përgatitje për provimet shtetërore)
- Foto të aktiviteteve

3. Projektet më të mira në lëndën e kimisë



SIGURIMI I MIRËQENIES SOCIALE, EMOCIONALE DHE SHËNDËTËSORE TË NXËNËSVE

Prill 2017

Qëllimi: Të promovojë interesat , aftësitë , e nxënësve në klube të ndryshme social kulturore dhe përfshirjen e tyre pa dallime.

“Ligji dhe unë”

Jemi mësuar shpesh që në faqen e shkollës të shohim fotot e aktiviteteve të shumta që Petroninsat me shumë dashuri organizojnë në holl e klasa .
Sot keto aktivitete kaluan muret e shkollës dhe shkuan në sallën e “UET” ku në mënyrë dinjitoze nxënësit tonë dhanë konferencën me temë “Ligji dhe unë” e mbështetur nga klubi social.

Falenderojmë nxënësit pjesëmarrës që treguan qytetari maksimale .

"Ligji dhe unë"



Aktivitet i organizuar nen kujdesin e mësuesve te Edukimit Fizik

Tetor 2016

Qëllimi: Njohja e sakrificave dhe aspiratave të brezit të rinisë shqiptare në kohën e luftës, nëpërmjet pasardhësve të tyre, nga nxënësit tanë.

“Shkembim pervojash dhe emocionesh”

Aktivitetet e zhvilluara në kuadër të fushatës së afrimit të nxënësve me sportin dhe aktivitetin fizik. Në këto aktivitete marrin pjesë nxënësit e shkollës, prindër si dhe banorë të komunitetit përreth shkollës. Aktivitetet zgjatën disa ditë dhe u kurorëzuan me stimuj dhe vlerësime të ndryshme.



Aktivite të ndryshme në kuadër të fushatës -Eja ne PNL te lexosh! *Tetor 2016*

Qëllimi: Bashkëpunim dhe shkëmbim përvojash të nxënësve të shkollave “Rraqi Qirinxhi” në Korçë dhe “Petro Nini Luarasi”, Tiranë.

Aktivitetet zhvillohen në shkollë nga nxenesit e klasave të 10 dhe 12-ta. Pasdite tematike me të ftuar prindër, nxënës ku libri kthehet në qëndër të vëmendjes së tyre, tërhoqi shumë nxënës të gjimnazit tonë. Fushata:

Takohe mi për një liber.

Nxenesit e Petro Nini Luaramoren pjesë ditën e diele, ku përreth një ore e gjysëm degjuan personazhe të letërsisë si Ana Karenina, Hamleti, Don Kishot, Tat Tannushi, Doruntina e Piter Pan të lexojnë letërsi të jashtëzakonshme.

Eja ne Pnl te lexosh!



sit



Veprimtari për zhvillimin artistik, kulturor e sportiv.

Prill 2017

Qëllimi: Bashkëpunim dhe shkëmbim përvojash të nxënësve të shkollave “Rraqi Qirinxhi” në Korçë dhe “Petro Nini Luarasi”, Tiranë.

“E premtja sportive me komunitetin”

Në kuadër të veprimtarive praktike të përcaktuara në planin e punës si shkollë qëndër komunitare në departamentin e Edukimit fizik për muajin Prill u zhvillua loja Frisbit. Ky aktivitet u zhvillua në bashkëpunim me shoqatën sportive Amerikane “100 mijë disqe” në parkun e madh të liqenit

Një masë e madhe nxënësish morën pjesë së bashku me prindërit dhe mësuesit e shkollës.



SIGURIMI I MIRËQENIES SOCIALE, EMOCIONALE DHE SHËNDETËSORE TË NXËNËSVE

Prill 2017

Qëllimi: Të promovojë interesat , aftësitë , e nxënësve në klube të ndryshme social kulturore dhe përfshirjen e tyre pa dallime.

Projekti qytetar kundër korrupsionit

Ky projekt u mbështet nga klubi social.Në sallën e UET u fol për konceptin e korrupsionit,statistikat ne Shqipëri dhe në botë dhe për pasojat e tij.




Veprimtari për angazhimin dhe mbështetjen e familjes

Nëntor 2016

Qëllimi: Ndërgjegjësimi i pjesëmarrësve mbi format,shkaqet dhe pasojat e bullizmit

Takim me temë:"Parandalimi i bullizmit mes të rinjve

Diskutim i formave fizike,emocionale dhe sociale të bullizmit.Eksplorimi i shkaqeve të bullizmit.Ky aktivitet u realizua nga psikologia e shkollës tonë.



Veprimtari për zhvillimin artistik, kulturor e sportive *Nentor 2016*

Qëllimi: Ndërgjegjësimi i pjesëmarrësve mbi format, shkaqet dhe pasojat e bullizmit

"Festival talentesh dhe angazhimesh"

Javët e prezantimit të arritjeve dhe produkteve në fusha të ndryshme

Ky aktivitet u zhvillua në ambjentet e shkollës tonë me praninë e komunitetit dhe nxënësve të shkollës nën kujdesin e mësuese Mirela Katundi. Nxënësit u paraqitën me gatime që përfshinin të gjitha zonat.



Veprimtari për zhvillimin akademik të nxënësve

Prill 2017

Qëllimi: Të plotësoje nevojat e nxënësve me njohuri të thelluara në fushën e Matematikës

Konsultime dhe përditësimi i faqes së web-it, konsultime në matematikë


1. Konsultime

2. Përditësimi i faqes së web-it (Rea Tresa)

- a) Video për limitet
- b) Projekt "Ndërtimi i grafikëve të funksioneve të përbërë trigonometrikë. Përdorimi i TIK në funksion të interpretimit matematik.
- c) Detyra matematike për klasën e IX-të dhe maturantët (përgatitje për provimet shtetërore)
- ç) Foto të aktiviteteve

3. Montimi filmik i dramatizimit "Matemofobia"

(Nxënësit e klasës së XI-A)



SIGURIMI I MIRËQENIES SOCIALE, EMOCIONALE DHE SHËNDETËSORE TË NXËNËSVE

Prill 2017

Qëllimi: Të promovojë interesat , aftësitë , e nxënësve në klube të ndryshme social kulturore dhe përfshirjen e tyre pa dallime

SHFAQJA TEATRALE "Pallati 176"

Me ndihmën e klubit social, nxënësit e klasave të 10 dhe 11 me talent në fushën e aktrimit shfaqën në sallën e teatrit të kukullave komedinë "Pallati 176 ". Ishte një mbrëmje e mbushur me shumë emocione.
Suksese artistëve tanë!



Veprimtari per zhvillimin artistik, kulturor e sportiv

Nentor 2016

Qëllimi: Të nxisë, afrojë, tërheqë dhe zhvillojë partneritet me komunitetin e

E premtja sportive me komunitetin

Në kuadër të veprimtarive praktike të përcaktuara në planin e punës në departamentin e Edukimit fizik për muajin NENTOR, mësueset Yllka Cela dhe Enerida Mema në bashkëpunim dhe me departamentin e historisë realizuan ditën e mërkurë në orën 16 një aktivitet kulturor me këngë e valle me motive patriotike. Aktiviteti u organizua në hollin e shkollës sonë ku kishte të ftuar veteranë, mësues, prindër dhe nxënës.

Në fund grupi i valleve të shkollës sonë përshëndetën të pranishmit me "Vallet e Shqipeve"



Veprimtari për angazhimin dhe mbështetjen e familjes

Nentor 2016

Qëllimi: Sensibilizimi i familjeve, të rinjve në luftën kundër dhunës

Projekti He for She "Zgjidhja vjen nga burrat/djemtë"

Një projekt i cili është në vazhdimësi i kryesuar nga mësuesja e letërsisë Orjana Osmani



Veprimtari për zhvillimin artistik, kulturor e sportiv

Mars 2017

Qëllimi: Të nxisë, afrojë, tërheqë dhe zhvillojë partneritet me komunitetin e gjerë brenda dhe rreth shkollës

"E premtja sportive me komunitetin"

Në kuadër të veprimtarive praktike të përcaktuara në planin e punës si shkollë qendër komunitare në departamentin e Edukimit fizik për muajin MARS u zhvillua Cup Song.

Një masë e madhe nxënësish të klasës së X dhe XI performuan në datën 25 mars.

Shqipëria u fut në librin e rekordeve Guinness!



Veprimtari për zhvillimin artistik, kulturor e sportiv. Arteve

Mars 2017

Qëllimi: Të nxisë, afrojë, tërheqë dhe zhvillojë partneritet me komunitetin e gjerë brenda dhe rreth shkollës .

“E premtja sportive me komunitetin”

Në kuadër të veprimtarive praktike të përcaktuara në planin e punës si shkollë qendër komunitare në departamentin e Edukimit fizik për muajin SHKURT u zhvillua klasa e zumbës.

Një masë e madhe nxënësish mësuan Kërcim Zumba (8’) dhe performuan në ditën e verës.



Veprimtari për angazhimin dhe mbështetjen e familjes

Nentor 2016

Qëllimi: Nxitja e talenteve, bashkëpunimit në grup dhe analiza e veprave duke i përjetuar vetë nxënësit emocionet e personazheve.

Programe në mbështetje të prindërve - Workshop me temë "Menaxhimi i sjelljes së fëmijëve në shkollë, familje, shoqëri."

Tek FOCUS grup u plotësuan pyetësorët nga prindërit, mësuesit, nxënësit.



Veprimtari për zhvillimin akademik të nxënësve

Nentor 2016

Qëllimi: Të plotësoje nevojat e nxënësve me njohuri të thelluara në fushën e matematikës, Fizikës

Konsultime të thelluara në lëndën e matematikës.

1.Konsultime "Funksonet trigonometrike" Kl XI_G dhe XI-A dt 26-11-2016 dhe 03. 12. 2016

2.Ndërtimi i këndit "Formulat e rëndësishme trigonometrike" Nxënës të kl XI_E 13 -14 -15 Nëntor 2016



SIGURIMI I MIRËQENIES SOCIALE, EMOCIONALE DHE SHËNDETËSORE TË NXËNËSVE

Mars 2017

Qëllimi: Të promovojë interesat , aftësitë , e nxënësve në klube të ndryshme social kulturore dhe përfshirjen e tyre pa dallime.

Një kafe për 8 mars në petronin

Me rastin e festës së 8-Marsit klubi social i shkollës organizoi një veprimtari të vecant në bibliotekë.Takimi i organizuar me dashuri dhe rrespekt për moshën e tretë u mendua të realizohej duke ftuar në shkollë disa gjyshe që kanë nipin ose mbesën nsënës në Petronin.Ato u pritën me dashuri dhe filluan të bisedojnë me nxënësit mbi jetën si dhe raportet që krijojnë çdo ditë me brezin e ri.Në takim morën pjesë edhe mësues,drejtoresha dhe nëndrejtoreshat e shkollës.

Gëzuar gjyshet tona të dashura! Ne duam tju bëjmë krenar!



Veprimtari për angazhimin dhe mbështetjen e familjes

Mars 2017

Qëlimi: Përfshirja e prindërve në zhvillimin e kompetencave të nxënësve, duke i bërë ata bashkëorientues në zhvillimin e tyre emocional dhe social.

Në kuadër të veprimtarive sportive të përcaktuara në planin e departamentit të Edukimit Fizik për muajin Mars një vend të vecantë ju kushtua aktivizimit të fëmijëve të vegjël moshë (7-10 vjec) në lojë të dashur për ta, lojë të futbollit. Morën pjesë fëmijët së bashku me prindërit dhe me mësuesit e shkollës.



Veprimtari për zhvillimin akademik të nxënësve

Nentor 2016



Qëlimi: Mbështetja e nxënësve dhe e komunitetit të nxënësve të shkollave të ndryshme.

Projekti SEECEL

Shkëmbim eksperience me shkolla pjesëmarrëse si Universiteti I Uellsit dhe shkollave 9-vjeçare në Kroaci.

Kompetenca e sipërmarrjes është kompetencë kyç në edukimin dhe arsim.

Komunikimi u realizua nëpërmjet web-it.



SIGURIMI I MIRËQENIES SOCIALE, EMOCIONALE DHE SHËNDETËSORE TË NXËNËSVE

Dhjetor 2016

Qëllimi: Informimi dhe zgjerimi i njohurive rreth ligjit, të drejtave dhe detyrave të cdo qytetari.

Me këtë aktivitet që kalon muret e shkollës dhe vizitohet shkolla "28 Nëntori", Shkodër - Qendër Komunitare. U përfaqësua denjësisht për të dytën herë nga grupi i konferencierve të "Ligji dhe unë" dhe grupi i debatit. Një ditë bashkëpunimi, miqësie dhe këmbimi eksperiencash. Drejtorja e shkollës së bashku me koordinatore të këtij aktiviteti, mësuesja Mirela Katundi dhe nxënësjja Jeta Kreka, hapën sirtarin e përgatitjes për Konventën Ligjore të Gjimnazistëve. Shumë surpriza na presin nga "Ligji dhe Unë" në aktivitete të tjera.



Veprimtari për zhvillimin akademik të nxënësve

Mars 2017

Qëllimi: Të plotësojë nevojat e nxënësve me njohuri të thelluara në fushën e Matematikës, Fizikës

Konsultime dhe përditësimi i faqes së web-it, konsultime në fizikë

1. Konsultime


- a) "Prerja e trupave gjeometrikë me një plan të caktuar" – Matematikë bërthamë 11-04-03-2017
- b) "Njehsimi vëllimor, syprinor i trupave" – Matematikë bërthamë 11-03-2017
- c) "Vërtetimi i identiteteve trigonometrike" – Matematikë e thelluar 12-03-2017

2. Përditësimi i faqes së web-it (Rea Tresa)

- a) 10 ushtrimet e muajit
- b) Zhvillimi i testit të inteligjencës – fusha matematikë – Konkursi Kangaroo 18-03-2017
- c) Detyra matematike për klasën e IX-të dhe maturantët (përgatitje për provimet shtetërore)
- ç) Foto të aktiviteteve

3. Montimi filmik i dramatizimit "Matemofobia" deri më datë 31.03.2017 (Nxënësit e klasës së IX-A)

Departamenti I Fizikës bëri mledhjen e radhës për të përcaktuar detyrat që na dalin para provimeve të Matures Shtetërore. Në këtë mbledhje u vendos për oraret dhe grafikun e konsultimeve si dhe për mbasditen e fizikës që do të organizohet javën e parë të muajit prill.



SIGURIMI I MIRËQENIES SOCIALE, EMOCIONALE DHE SHËNDETËSORE TË NXËNËSVE

Mars 2017


Qëllimi: Të promovojë interesat , aftësitë , e nxënësve në klube të ndryshme social kulturore dhe përfshirjen e tyre pa dallime.

EKSPOZITA NË DESTIL

Me ndihmën e klubit social, nxënësit me talent në fushën e pikturës hapën në lokalin Destil një ekspozitë me punimet e tyre. Në këtë veprimtari morën pjesë shumë nxënës të talentuar. Gjatë ekspozitës pati edhe muzikë dhe këngë live nga GJ.Kacinari dhe nxënësja e vitit të parë Endi Cini. Ishte mbrëmje me shumë fines sic i takon talenteve të

Petroninit.

Sukusese artistëve tanë.



SIGURIMI I MIRËQENIES SOCIALE, EMOCIONALE DHE SHËNDETËSORE TË NXËNËSVE

Dhjetor 2016

Qëllimi: Të promovojë interesat , aftësitë , e nxënësve në klube të ndryshme social kulturore dhe përfshirjen e tyre pa dallime.

"Kartolina urimi për të moshuarit"

Ky aktivitet u zhillua nga klubi social i shkollës nën drejtimin e mësueses Mirela Katundi në shtëpinë e të moshuarve. Krijimi i një qytetari të ri me frymen e vullnetarizmit do të jetë një nga prioritetet e shkollës sonë. Dhe ku më mirë se në këtë institucion do të shprehej kjo? Atmosfera e krijuar ishte mjaft festive dhe të gjithë mikëpritësit tanë, si ata të moshuar edhe punonjësit e institucionit pritënme kënaqsi vizitën tonë, e cila tani është bërë një aktivitet i përvitshëm . Shërbimi ndaj komunitetit do të jetë prioritet i yni.



SIGURIMI I MIRËQENIES SOCIALE, EMOCIONALE DHE SHËNDETËSORE TË NXËNËSVE

Dhjetor 2017

Qellimi: Të promovojë interesat , aftësitë , e nxënësve në klube të ndryshme social kulturore dhe përfshirjen e tyre pa dallime.

Këtë vit shkollor Klubi i çështjeve sociale, i cili ka arritur në 300 numrin e anëtarëve, ka ndër marrë një sërë nismash. Aktiviteti më i zgjeruar në këtë fundvit që u zhillua nga klubi social i shkollës nën drejtimin e mësueses Mirela Katundi dhe kyetarëve të nëngrupeve sociale ishte shpërndarja e ndihmave për familjet në nevojë. Pas sensibilizimit të nxënësve në shkollë u mbledhën nga të gjithë nxënësit dhe u shpërndanë ndihma ushqimore për 50 familje në nevojë të Njësisë 5 dhe ushqime dhe veshje për nxënësit e shkollës "Lidhja e Prizrenit" në Paskuqan të Tiranës Qark, si dhe në QSUT në klinikën Pediatrike. Kjo nismë u mbështet dhe nga senati.



Veprimtari për zhvillimin artistik, kulturor e sportiv.

Shkurt 2017

Qellimi: Të nxisë, afrojë, tërheqë dhe zhvillojë partneritetet me komunitetin e gjerë brenda dhe rreth shkollës .

“E premtja sportive me komunitetin”

Në kuadër të veprimtarive praktike të përcaktuara në planin e punës si shkollë qendër komunitare në departamentin e Edukimit fizik për muajin SHKURT u zhvillua klasa e zumbës. Ky aktivitet u drejtua nga përfaqësues të shkollës së dancit. Pjesëmarrës vajza të klasave të 10-ta dhe 11-ta dhe grupi I kërcimit. Nxënësit kaluan hareshëm orët me muzikë dhe ushtrimet e zgjedhura për këtë rast.



Veprimtari për zhvillimin artistik, kulturor e sportive

Shkurt 2017

Qëllimi: Të nxisë, afrojë, tërheqë dhe zhvillojë partneritet me komunitetin e gjerë brenda dhe rreth shkollës .

Aktivitet për pavarësinë e Kosovës

Në kuadër të veprimtarive të përcaktuara në planin e punës në departamentin e Historisë për muajin shkurt u zhvillua aktiviteti me rastin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës nën kujdesin e mësuesit të historisë Artan Nuriu. U shfaq dhe një dokumentar i realizuar nga nxënësit. <https://drive.google.com/file/d/>



SIGURIMI I MIRËQENIES SOCIALE, EMOCIONALE DHE SHËNDETËSORE TË NXËNËSVE

Dhjetor 2016

Qëllimi: Të promovojë interesat , aftësitë , e nxënësve në klube të ndryshme social kulturore dhe përfshirjen e tyre pa dallime.

Qeveria e nxënësve me iniciativën dhe mbështetjen e mësuesesve të shkollës dhe mësueses koordinatorë të Klubit të çështjeve sociale, një ditë para Krishlindjeve kanë gatuar dhe kanë shpërndarë ndihma. Ndjenja e humanizmit dhe bashkëpunimit në grup edukon brez social, të duan njëri-tjetrin dhe të ndihmojnë njerëz që kanë nevojë. Klubi social i shkollës nën drejtimin e mësueses Mirela Katundi dhe u shpërndanë ndihma ushqimore.



BASHKËPUNIMI ME KOMUNITETIN

Dhjetor 2016

Qëllimi: Nxitja e bashkëpunimit në grup, shkëmbimi i ideve dhe përfshirja e prindërve në zhvillimin e kompetencave të nxënësve.

“Liria e fjalës dhe etika në media”

Ideja e patrajtë, e paformë, për të realizuar një aktivitet që do t'i kalonte caqet dhe kufijtë e shkollës dhe do të përfaqësonte një projekt të mirëfilltë dhe një qasje më të cilësueshme ndaj medias në Shqipëri dhe përfshirjes në të, hodhi rrënjë në “Grupin e Gazetarëve PNL” dhe në një mënyrë të natyrshme u ndërmorën hapat e njëpasnjëshëm drejt realizimit të një projekti të tillë.

Ky aktivitet solli në formësimin e vet tërësisht original, një përballje ndërmjet një brezi që është në betejën e vazhdueshme që përjeton çdo individ që vazhdon përcapjet e para në oazin e panjohur të gazetarisë dhe medias dhe një brezi tashmë të afirmuar në këtë fushë, gazetaria .

Në këtë panel spikatën emra sigurisht të shumëdëgjuar, edhe më parë: Alma Çupi, Aleksandër Çipa, Prec Zogaj dhe Zamir Alushi, përballë të cilëve u gjendën disa nga të rinjtë që përbëjnë grupin gazetaresk në gjimnazin “Petro Nini Luarasi”, në një bisedë të ngrohtë që do të hidhte sado pak dritë mbi një temë të gjithëkohshme si ajo e lirisë së medias në Shqipëri dhe etikës në të.





Veprimtari për zhvillimin akademik të nxënësve

Shkurt 2017

Qëllimi: Të plotësoje nevojat e nxënësve me njohuri të thelluara në fushën e matematikës, Fizikës

Konsultime të thelluara në lëndën e matematikës.

Në datat 4 dhe 11 shkurt konsultimet në lëndën e matematikës. Në datat 11,12,13 dhe 16 shkurt provat për realizimin e dramatizimit "Matefobia". Është përditësuar faqja e web-it të klubit në ndihmë të nxënësve në nevojë.



SIGURIMI I MIRËQENIES SOCIALE, EMOCIONALE DHE SHËNDETËSORE TË NXËNËSVE

Shkurt 2017


Qëllimi: Të promovojë interesat , aftësitë , e nxënësve në klube të ndryshme social kulturore dhe përfshirjen e tyre pa dallime.



Dua dhe atë që është ndryshe nga unë

Veprimtari e disa nxënësve anëtarë të klubit social u realizua midis fëmijëve me sindromën Down dhe me institutin e fëmijëve të verbër. Një kromozon tepër shpreh një dashuri më të madhe se normalja. Nxënësit bënë një workshop me piktura dhe ngjyrosje të figurave. Pasditja la mbresa tek pjesëmarrësit. Me synimin për të mbështetur këta fëmijë ,veprimtaritë do vazhdojnë dhe muajt e ardhshëm.

Në kuadër të veprimtarive praktike të përcaktuara në planin e punës në departamentin e Edukimit fizik për muajin DHJETOR u zhvillua kampionati në rang shkolle ku u shpall fitues klasa 12 L pasi u ndeshën në finale me klasën 12H.



Veprimtari per zhvillimin artistik, kulturor e sportiv.

Dhjetor 2016

Qëllimi: Të nxisë, afrojë, tërheqë dhe zhvillojë partneritet me komunitetin e gjerë brenda dhe rreth shkollës .

“E premtja sportive me komunitetin”

Në kuadër të veprimtarive praktike të përcaktuara në planin e punës në departamentin e Edukimit fizik për muajin DHJETOR u zhvillua kampionati në rang shkolle ku u shpall fitues klasa 12 L pasi u ndeshën në finale me klasën 12H.



Veprimtari për zhvillimin artistik, kulturor e sportiv

Dhjetor 2016

Qëllimi: Të nxisë, afrojë, tërheqë dhe zhvillojë partneritet me komunitetin e gjerë brenda dhe rreth shkollës .

Shahu në PNL

Në kuadër të veprimtarive praktike të përcaktuara në planin e punës në departamentin e Edukimit fizik për muajin DHJETOR u zhvillua Kampionati i shahut në rang shkolle.



Veprimtari për angazhimin dhe mbështetjen e familjes, Fusha 3

Dhjetor 2016

Qëllimi: Përfshirja e prindërve në zhvillimin e kopetencave të nxenesve, duke i bërë ata bashkëorientues në zhvillimin e tyre emocional dhe social.

"E premtja e përbashkët me prindër dhe komunitet"

Në kuadër të përfshirjes së komuniteteve të shkollës në aktivitete të përbashkëta, me iniciativën e Departamentit të Edukimit fizik, e premtja e fundit e dhjetorit angazhoi në një ndermarrje të përbashkët prindër, mësues dhe nxënës në fushat sportive të shkollës. Ky aktivitet shënon vazhdimin e suksesshëm të bashkëpunimeve të shkollës me komunitetet e saj, e cila do të vazhdojë të promovojë projektet e saj edhe në komunitetin rreth saj.



Veprimtari për angazhimin dhe mbështetjen e familjes, Fusha 3

Dhjetor 2016

Qëllimi: Përfshirja e prindërve në zhvillimin e kompetencave të nxenesve, duke i orientuar ata drejt rrugës së lirisë së fjalës në një terren të mbrujtur me paliri.



"Liria e fjalës në Shqipëri".

Befasia trajtimit të temave tabu në shoqërinë shqiptare nga gjimnazistët dhe konceptet e tyre për të shprehur mendimin ashtu sic e ndiejnë, ishte ndjesia që I la aktiviteti me nxënësit dhe prindërit e gjimnazit tonë Znj Rita Petro. Kjo kërkesë, e dalë nga diskutimet e tyre në klasë u shtri edhe në nga biseda me eseisten,

poten dhe shkrimtaren, tashmë të njohur për këndvështrimet e saj kontraverse drejt së panjohurës së lirë të të shprehurit të shpirtit. Esetë e tyre mbi lirinë e të shprehurit, mund të qëndronin fare mirë përkrah simotrës së tyre, ndonëse temat ishin të ndryshme, dëshira për ndryshim në mentalitetin e shoqërisë shqiptare, ishte e njëjtë. Ajo çka trumbetohet në rrjetet sociale apo në disa media se brezi i ri sot nuk ka fytyrën e tij, i mungojnë idealet frymëzuese, se ata janë të prirur ndaj drogës e prostitucionit etj., etj., se është brez që nuk di shkrim e këndim, nuk është dukuri përgjithësuese. Këtë e tregoi edhe ky aktivitet, për të cilin u shkrua edhe në rrjetet sociale, po edhe nga vetë autorja Rita Petro.



Veprimtari për angazhimin dhe mbështetjen e familjes, Fusha 3

Dhjetor 2016

Qëllimi: Sensibilizimi i familjeve, të rinjve në luftën kundër dhunës

Projekti He for She "Zgjidhja vjen nga burrat/djemtë".

Në datën 22.12. 2016 u organizua eventi He for She me mbështetjen e organizates jofitimprurëse UN. Në këtë event morën pjesë një sërë personalitetesh si psh Drejtori ekzekutiv i UN Ministrisë të Mirëqenies dhe Rinise Blendi Klosi, gazetarë e sportistë mbështetës të nismës: Burrat si zgjidhje kundër dhunës ndaj gruas. Aktualisht kësaj nisme rezulton t'i jenë bashkëngjitur rreth 300 mijë burra e djem në Shqipëri. Mbështetës të kësaj nisme janë edhe futbollistët e kombëtares së Shqipërisë. Po kështu edhe shkolla jonë mbështet me një sërë aktivitetesh nismën He For She. Tashmë po lancohen dy produkte nga 11 e: 2 reklama, të cilat janë sensibilizuese për sjelljen e djemve ndaj vajzave. Bashkëpunëtorë edhe figura të njohura nga publiku dhe pjesëmarrës në shumë aktivitete si ish petroninsa.

